



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.
Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
Shkolla e Mesme Profesionale
"Charles Telford Erickson"
Golem – Kavaje

shkollaemesmeagrobiznesgolem@yahoo.it

Tel.0693870484

Nr 161 prot

Golem më 09, 04, 2024

Lenda: Njoftim për vend pune të lire.

Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore
Drejtoria së Marrëdhënieve me Publikun
Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive

Mbështetur në ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, kreu 14 neni 140 e neni 151, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554 datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", ligjit Nr. 69, datë 21.06.2012 "Për Sistemin Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar "Udhëzimit nr.14, datë 27.05.2021 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet të menaxhimit të burimeve njerëzore, përberjes së njësive së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit".

Ofruesi publik i AFP-se, Shkolla e Mesme Profesionale Charles Telford Erickson" Golem-Kavaje ju njofton krijimin e vendit të lire për pozicionin:

-Pergjegjes i Bazes Prodhuese te Shkolles.

Kriteret e marrjes në punë të Pergjegjesit te Bazes Prodhuese.

Kandidati aplikues për Pergjegjes Baze të ofruesit publik të AFP-së duhet të përmbushë kriteret, si më poshtë:

1. Kriteret të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të organizimit dhe

planifikimit strategjik, aftësi analitike për zgjidhjen e problemeve;

g) të demonstrojë aftësi drejtuese, të punës në grup dhe motivimit.

3. Kriteret e posaçme për përgjegjes Baze Prodhuese, që mbulon kulturën profesionale:

a) të ketë diplomë të studimeve universitare të nivelit “Master shkencor” (ose të barasvlershme)

në një nga fushat që lidhet me kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së;

b) të ketë të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar”;

c) të ketë punuar të paktën 5 vjet në një ofrues publik të AFP-së;

d) të ketë njohuri të certifikuara në përdorimin e teknologjisë së informacionit.

4. Të ketë përvojë pune të paktën 3 vjet në fushën që lidhet me kualifikimet profesionale profesionale të njërit prej drejtimeve mësimore të ofruesit të AFP-së.

Dokumentet e aplikimit.

1. Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

a) letërmotivimin për pozicionin;

b) jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të këtij udhëzimi;

c) kartën e identitetit

d) diplomën;

e) librezën e punës;

f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;

g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;

i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;

j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;

k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

2. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të ofruesit publik të AFP-së, brenda dates. 14 . 04 . 2024.

Drejtore
Matilda Canaku

